



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SYLLABUS i Lëndës Tatimet dhe Korporatat

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Tatimet dhe Korporata
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semestri VI)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	"Taksat dhe Korporatat" është një lëndë e domesdoshme për studentë apo persona që dëshirojnë të mësojnë Tatimet dhe Taksat si instrumentin themelor financiar me anë të cilit mbledhen të hyrat, e nga të cilat mbulohen shpenzimet e shtetit dhe plotësohen nevojat e shoqërisë së një vendi. Në shumicën e rasteve termat tatim dhe taksë përdoren në të njëjtin kuptim, megjithëse tatimet paguhen me tepër në bazë të të ardhurave ose fitimeve që realizohen dhe mallrave që konsumohen, kurse taksat për shërbimet e ndryshme që autoritetet shtetërore u bëjnë qytetarëve të tyre. Meqëse edhe Korporatat janë pjesë e fitimit dhe mbledhjes së të hyrave të shtetit në formë të TVSH-es, të ardhurave mbi pagën, akcizave etj., atëherë hyjnë si rast studimi në këtë lëndë.
Qëllimet e lëndës:	- Qëllimi kryesor është se studentët të jenë në gjendje të analizojnë vendimet kritike nga një perspektivë e tatimeve. - Qëllim tjetër me rëndësi i kësaj lëndë është që studentët të mësojnë strategjitë e tatimeve, aplikueshmërinë e tyre, sepse kjo do të jetë e vlefshme pavarësisht nga rruga e karrierës së tyre. - Studentët do të fitojnë njohuritë me ligjin e

	taksave, të mësojnë të njohin mundësitë e aplikueshmërisë së taksave, të njohin planifikimin mbi bazën e taksave dhe njëkohësisht të fitojnë përvojë duke përdorur mjetet e planifikimit tatimor dhe të jenë në gjendje në të ardhmen për të përmirësuar menaxhimin dhe organizimin e bizneseve sa i përket kësaj fushe.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: - Të shpjegojnë funksionimin dhe fushën sistemit tatimor; - Te shpjegojnë dhe të llogarisin detyrimet e tatimit mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi vlerën e shtuar; - Të shpjegojnë dhe të llogarisin tatimin në të ardhurat e korporatave; - Të shpjegojnë dhe të llogaritin fitimet e tatueshme që rrjedhin nga kompanitë dhe personat fizik dhe juridikë; - Të shpjegojnë dhe të llogaritin efektin e kontributeve dhe sigurimeve për punonjësit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit - Të kenë njohuri për këshillë dhënie tatimore kurdo që u kërkohet;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjësuar			

	Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime
Metodat e vlerësimit:	- Vijimi i ligjeratave - - Punimi seminarik me hulumtim 15% - Testi I 0 – 15 % - Testi II 0 – 15% - Provimi përfundimtar 0- 50% - Pjesëmarrja në ushtrime 0 - 5%
Literatura	
Literatura bazë:	- Harvey S. Rosen, Financat Publike, 2009, Tiranë - Prof.Dr Sabahudin Komoni “ Finaca Publike, 2008 - Fadil Govori (2011): Financa, IFM, Prishtinë, - Legjislacioni tatimor i Kosovës, Botim i ATK, 2012, Prishtinë
Literatura shitesë:	- Martin Feldstein, Janes R. Hines, Jr., and R. Glenn Hubbard, The effects of Taxation on multinacional Corporations - Cheryl D. Block, Corporate Taxation, Third Edition
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në teorinë e taksave dhe firmës në biznes - Kuptimi i aktivitetit biznesor - Format e organizimit të biznesit - Sistemi tatimor - Politika tatimore
Java e dytë:	Të ardhurat e tatueshme dhe tatimi i Korporatave - Tatimi i Korporatave - Të ardhurat e Korporatave - Normat e tatimit të Korporatave.
Java e tretë:	Struktura e Kapitalit të Korporatave
Java e katërt:	Tatimi i Dividendës në aksione
Java e pestë:	Tatimi i fitimit nga kapitali
Java e gjashtë:	Çështjet e tjera të Korporatave: - Formimi (fitmimet dhe humbjet mbi formimin e Korporatave), - Blerjet e tatueshme të Korporatave, - Likuidimi i Korporatave
Java e shtatë:	Riorganizimi i Korporatave: Pamje e përgjithshme

Java e tetë:	Kolokviumi i I-rë
Java e nëntë:	Ndarja e Korporatave
Java e dhjetë:	Pasojat tatimore të transferimit të pronës në një Korporatë të re apo egzistuese
Java e njëmbëdhjetë:	Kufizimet në strategjinë e fitimit të mbajtur - Tatimi ndëshkues
Java e dymbëdhjetë:	Taksat minimale alternative
Java e trembëdhjetë:	Tatimi i Korporatave shumëkombëshe
Java e katërbëdhjetë:	Globalizimi financiar - Faktorët e politikës ekonomike, - Shkalla e tatimeve të Korporatave
Java e pesëmbëdhjetë:	Kolokviumi i II-të

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
• Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore. • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.